REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Nr. 314 prot Maliq me 23/01/2025

PROJEKT VENDIM -NR. 13
PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I QIRASË PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, nenit 24, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKB Nr.139, datë 26.12.2024 "*Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", Këshillit të Bashkisë i

PROPOZOJMË

1. Të miratojë pagesën e qirasë për familjen e Z. Jani Nuri Koroni, e cila përfiton nga programi Subvencioni i Qirasë për strehim, në kushtet e emergjencës, sipas tabelës Nr.1 bashkëngjitur këtij Projekt-Vendimi.
2. Subvencioni i qirasë i jepet përfituesit bazuar në kontratën e qirasë të lidhur me pronarin social, nga momenti që lista e përfituesve miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe përfundon në momentin e strehimit të familjes në banesën e tyre, pas rikonstruksionit të saj, por jo më shumë se 1 vit, bazuar Kontratës Noteriale të qirasë të paraqitur prej Z.Koroni, me Nr.repertori:159 dhe Nr koleksioni:120, datë 14.01.2025.
3. Subvencioni paguhet drejtpërdrejt në llogari të pronarit të banesës.
4. Efektet financjare do të mbulohen nga Fondi Social i bashkisë Maliq, sipas tabelës Nr.2 bashkëngjitur këtij Projekt-Vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Maliq.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
P.Sektori Strehimi:	L. Mullalli		Dt. 23/01/2025
Dr. DSHSASH	E.Petriti		Dt. 23/01/2025
Jurist	J.Thomo		Dt. 23/01/2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

Tabela Nr.1 lista e përfituesve të programit të Strehimit Social, Subvencioni i Qirasë.

Nr.	Emër, atësia, mbiemër	ID	Përbërja familjare	Vendbanimi	Kategoria	Subvencioni Lek/muaj
1	Jani Nuri Koroni	G70324023T	2	Vlocisht	Familje pa të ardhura/Njëprindërore	7500

Tabela Nr.2. Fondet do të përballohen nga Buxheti i bashkisë Maliq, i vitit 2025, si më poshtë:

Gr.	Kap	Kod.Prog	Llog.Eko	Emërtim i Llogarisë	Vlera në lekë/muaj
00	05	01110	606	Fondi Social	7500

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
P.Sektori Strehimi:	L. Mullalli		Dt. 23/01/2025
Dr.DSHSASH	E.Petriti		Dt. 23/01/2025
Jurist	J.Thomo		Dt. 23/01/2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Nr 314 Prot

Datë 23/01/2025

RELACION
PËR PROJEKT VENDIMIN
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I QIRASË PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, nenit 24, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKB Nr.139, datë 26.12.2024 "*Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*".

Bazuar ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar, me ligjin nr. 48/2023 dhe VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*" ku thuhet se :

> "*Kushte emergjente për strehim, janë kushtet në të cilat ndodhen individët/familjet që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare, në banesa në proces legalizimi që pësojnë dëme për shkak të fatkeqësive natyrore. Në të gjitha situatat e gjendjes së emergjencës, kur procedura fillon me kërkesë të individit/familjes përfituese, ose kryesisht nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, emri/at / lista e aplikantëve paraqitet/n menjëherë në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për miratim*".

Më datë 22.01.2025 pranë zyrës së Strehimit Bashkia Maliq është paraqitur kërkesa me numër aplikimi BS220120250009, e Z.Jani Nuri Koroni ku kërkon nga Bashkia Maliq trajtimin me subvencin të qirasë pasi familja e tij ka mbetur e pa strehë për shkak të fatkeqësisë që i ka ndodhur së fundmi nga djegja e banesës së tij. Nga dokumentacioni i paraqitur nga Z. Koroni si dhe nga verifikimi i Njësisë Administative Libonik, familja jeton provizorisht në një banesë me qira me Kontratë Noteriale me Nr.repertori:159 dhe Nr. koleksioni:120, datë 14.01.2025. Sipas çertifikatës familjare janë 2 anëtarë, të kategorisë një prindërore dhe në kushte të vështira social ekonomike. Sipas Vërtetimit datë 20.01.2025 familja e Z. Koroni është baues në fshatin Vloçisht, Njësia Administrative Libonik. Me akt konstatimi datë 20.01.2025 banesa në të cilë jetonte familja Z.Koroni është dëmtuar plotësisht nga zjarri.
Sipas formularit të Shërbimit Social datë 20.01.2025 familja është në kushte të vështira social ekonomike, dhe për shkak të diegies së banesës jetojnë me qira. Referuar kontratës së qirasë Nr.repertori.159 dhe Nr.koleksioni:120, datë 14.01.2025 "*Për marrje me qira të një pjesë të ndarë me sipërfaqe 50m2 ndodhur tek ndërtesa e pasurisë Arë+Truall+Ndërtesë me*

nr.pasurie 137/878 ndodhur në fshatin Vloçisht", pagesa do të bëhet sipas VKM nr. 362, datë 29.5.2019 "*Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij*" dhe VKB Nr.139, datë 26.12.2024 "*Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", niveli maksimal për trajtimin e një familje me 2 anëtarë është 7.500 lekë/muaj.
Pagesa e subvencionit të qirasë do të përballohet nga buxheti i bashkisë Maliq, i vitit 2025, nëpërmjet Fondit Social.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
P.Sektori Strehimi:	L. Mullalli		Dt. 23/01/2025
Dr. DSHSASH	E.Petriti		Dt. 23/01/2025
Jurist	J.Thomo		Dt. 23/01/2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ